



Datë: 05.12.2025
Numër Protokoli: 7816/2025

A.nr.1634/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1634/2025, të datës 28.08.2025, të parashtruar nga ankuesja A.Z, kundër organit të punësimit: Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 05.12.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1634/2025, e datës 28.08.2025, e parashtruar nga ankuesja A.Z.

II. Anulohet në tërësi procedura e pranimit lidhur më pozitën Zyrtar i Lartë për Kimikate në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, e shpallur sipas konkursit me numër reference RN00017394.

III. Obligohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmerr veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e vendimit sikurse përcaktohet në pikën II të dispozitivit.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarr në kuptim të zbatimit të vendimit.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbim civil, A.Z (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), më datë 28.08.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër konkursit me numër reference RN00017394, pozita Zyrtar i Lartë për Kimikate, i shpallur nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (tutje referuar MMPHI), ndërsa, kjo e fundit, ka përcjellë përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit), vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 5772/2025 të datës 28.08.2025 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin e datës 31.07.2025 për kandidatin fitues; Konkursin me Nr. Reference: RN00017394, për Grupin e Përgjithshëm të Mjedisit, pozita Zyrtar i Lartë për Kimikate; Kopjen e ID-së së ankueses; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 08.09.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 30.09.2025; Formularin e renditjes përfundimtare të kandidatëve i datës 31.07.2025; Listën e pyetjeve të intervistës me gojë datë 19.06.2025; Formularët e vlerësimit të intervistës me gojë për ankuesen dhe kandidatin fitues; Njoftimin e datës 11.06.2025 për kandidatët që kanë kaluar testin me shkrim; Testin me shkrim i kandidatit fitues dhe ankueses; Formularët e vlerësimit të eses; Vendimin me numër protokolli 4287/25 të datës 29.05.2025 për themelimin e Komisionit të Pranimit; Vendimin me numër protokolli 4287-2/25 të datës 30.05.2025 për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të datës 29.05.2025 për formimin e komisionit të pranimit; Akt Emërimet e anëtarëve të komisionit të pranimit; Listën e kandidatëve të aprovuar dhe refuzuar; Ri njoftimin e datës 21.05.2025 për verifikim paraprak; Njoftimin e datës 20.05.2025 për verifikimin paraprak; Listën e aplikantëve; Vendimin e datës 08.05.2025 për shtyrjen e afatit të përfundimit të verifikimit; Aplikacionin e kandidatit B.K të datës 27.03.2025 me dokumentacionin nga faqe 25; Aplikacionin e ankueses i datës 23.04.2025 me dokumentacionin nga faqe 1-32; Përshkrimin i punës për pozitën Zyrtar i Lartë për Kimikate.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë ka gjetur se pretendimet ankimore janë të bazuar, **sepse:**

Gjendja e Çështjes

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton:

-MMPHI më datë 24.03.2025, ka shpall konkursin me Nr. Ref: RN00017394, për Grupin e Përgjithshëm të Mjedisit, pozita Zyrtar i Lartë për Kimikate, si kategori e specialistit, i hapur për aplikim nga data 25.03.2025 deri më datën 23.04.2025.

-Në konkursin përkatës të punësimit ka aplikuar edhe ankuesja së bashku me 48 kandidatë të tjerë, dhe së e njëjta ishte përfshirë në listën e ngushtë, si kandidate që ka plotësuar kriteret e pozitës së shpallur.

-Divizioni për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore i MMPHI-së më datë 31.07.2025, ka shpallur listën përfundimtare të vlerësimit sipas të cilës rezulton se ankuesja ka grumbulluar gjithsej 86.4 pikë, duke u renditur si kandidatja e tretë më pikë të arritura, ndërsa, sipas njoftimit për kandidatin fitues të datës 31.07.2025 si kandidat fitues është shpallur B.K me gjithsej 92.4 pikë,

Pretendimet ankimore

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pretendon se janë bërë shkelje ligjore në këtë procedurë dhe parregullsi sikurse është thënë në Vendimin me nr. prot:5361/2025 të datës 05.08.2025 të KPMSHCK-së.

Vlerësimi i Kolegjit

Kolegji i Këshilli mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “*Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes*”, ka shqyrtuar në kuptim të ligjshmërisë veprimet procedurale të ndërmarra në procedurën e pranimi më numër të referencës RN0001739. Rrjedhimisht, në kuptim të ushtrimit të autorizimeve ligjore të organit publik në procedurë të pranimi në shërbim civil, Kolegji i Këshillit nga administrimi shkresave të lëndës ka gjetur së pozita e Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së është e lirë që nga muaji qershor 2021 dhe se kjo pozitë ende vazhdon të ushtrohet me ushtrues detyre.

Andaj, duke qenë së shpallja e konkursit behët vetëm pas miratimit (gojor apo më shkrim) të Sekretarit të Përgjithshëm në cilësi të Zyrtarit Kryesor Administrativ dhe duke qenë së themelimi i Komisionit të Pranimi është kompetencë ekskluzive vetëm e Sekretarit të Përgjithshëm, kolegji ka trajtuar çështjen e kompetencës së ushtruesit të detyrës të Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së, vetëm në vështrim të legjislacionit në fuqi gjegjësisht Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik (i aplikueshëm nga data 26.09.2023) si dhe referuar kohës nga shpallja e konkursit deri tek akti përfundimtar i kontestuar. Kështu që, mbi këtë bazë, Kolegji mori parasysh përcaktimet ligjore sipas nenit 35 të këtij ligji, i cili në mënyrë shprehimore parasheh se : *1 Në rast se një pozitë e nivelit drejtues brenda strukturës organizative të institucionit mbetet e lirë, nëpunësja/i i nivelit të lartë drejtues e atij institucioni e cakton me vendim ushtruesen/in e detyrës për pozitën e lirë. 2. Në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, ushtruesja/i i detyrës mund të caktohet zyrtarja/imë i lartë i kategorisë pasuese, në vartësi të pozitës që caktohet, nga cilado njësi organizative brenda institucionit. 3. Zyrtarja/i publik nuk mund të caktohet si ushtruese/i detyre më gjatë se gjashtë (6) muaj. Kur pozita nuk mund të plotësohet brenda afatit gjashtë (6) muaj, ky afat mund të zgjas më së shumti edhe për gjashtë (6) muaj të tjerë. 4. Pozita e lirë nuk mund të zëvendësohet me ushtrues detyre për më gjatë se afati i përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni. 5. Çdo vendim i marrë nga ushtruesja/i i detyrës, pas kalimit të afatit të përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni, është i paligjshëm.* Rrjedhimisht, më hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë të gjitha institucionet publike në kuadër të kësaj edhe MMPHI-ja, kanë qenë të obliguara që emërimin e ushtruesit të detyrës për pozitën drejtuese të lira t’a bëjnë në pajtim të plotë më kërkesat ligjore të parapara më këtë ligj, ndërsa, sipas provave të lëndës përkundër që pozita e Sekretarit të

Përgjithshëm të MMPHI-së nuk ishte e plotësuar, ministri-ja i/e MMPHI-së nuk ka nxjerrë akt të ri për caktim të ushtruesit të detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm në pajtim me këtë ligj, por kjo pozitë ushtrohej deri me datë 11.10.2024, më zëvendësues (sipas Vendimit Nr.225, të datës 07.06.2023). Tutje, më Vendimin nr.313 të datës 11.10.2024, zyrtari A.M në pozitën e Drejtorit të Shpronësimit caktohet ushtrues i detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së, pozitë të cilën e ka ushtruar deri më datë 18.12.2024, ku më pastaj me Vendimin Nr.315, të datës 19.12.2024, të ministrit të MMPHI-së, I.B në pozitën e Drejtorit të Departamentit për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave, caktohet ushtruese i detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm pozitë të cilën ende e ushtron mbi bazën e vendimit të datës 19.12.2024. Pra, mbi gjendjen e fakteve si me sipër rrjedhë së pozita e Sekretarit të Përgjithshme të MMPH-së ishte ushtruar me tejkalim të afatit ligjor të përcaktuar më nenin 35 i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Për më tepër, në kuptim të konstatimit si me lartë, Kolegji i Këshillit mori parasysh Aktgjykimin P.A.nr.07/2025, të datës 10.06.2025, të Gjykatës Supreme të Kosovës, përmes të cilit vendim gjykata ka dhënë interpretim lidhur me nenin 35 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe efektet juridike të këtij neni. Në fakt, Gjykata Supreme me Aktgjykimin P.A.nr.07/2025, të datës 10.06.2025, ka përcaktuar se : *...Nga kjo dispozitë rrjedh qartë se çdo akt juridik i nxjerrë nga një udhëheqës në cilësinë e ushtruesit të detyrës pas skadimit të afatit prej një viti është i pavlefshëm në thelb, për shkak të mungesës së kompetencës ligjore për të ushtruar funksionet që burojnë nga ajo pozitë..... Ligji i referohet pozitës si funksion institucional dhe jo individit si person. Pra, ndërrimi i personit nuk e ndërpret dhe nuk e rifillon afatin gjashtë mujor, përkatësisht njëvjeçar të ushtrimit të përkohshëm të pozitës. Kjo qasje është në përputhje me frymën e ligjit që kërkon stabilitet, profesionalizëm dhe përgjegjësi institucionale në udhëheqjen publike.*

Si me sipër, dhe pas konstatimit se autorizimi për shpalljen e procedurës më Nr. Reference: RN00017394 dhe themelimi i Komisionit të Pranimi janë veprime të ndërmarra nga ushtruesi i detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së jashtë afatit ligjor 1 vjeçar të përcaktuar më nenin 35 i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, atëherë, në vlerësimin e Kolegjit këto veprime cilësohen si veprime të ndërmarra personi në mungesë të kompetencës ligjore dhe si të tilla në tërësinë e saj cenojnë ligjshmërinë e procedurës së kontestuar, kështu që, mbi këto rrethana ligjore procedura më Nr. Reference: RN00017394, konsiderohet si procedurë e paligjshme në kuptim të nenit 52, paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Thënë si më lartë, Kolegji në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 132 paragrafi 4 të Ligj Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, e me qëllim të kthimit të ligjshmërisë, vendosi për aprovimin e ankesës si të bazuar, duke anuluar në tërësi procedurën e pranimi sipas konkursit me Nr. Ref: RN00017394.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.1634/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesve A.Z;
- Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në MMPHI; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.